

Në bazë të nenit 114 dhe nenit 37 paragrafit 6 të Ligjit për arsimin e lartë (Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 82/'18, 178/'21, 58/'24); nenit 163 dhe nenit 349 paragrafit 6 të Statutit të Universitetit të Tetovës; nenit 52 dhe nenit 105 paragrafit 6 të Statutit të Fakultetit Ekonomik, dekani i Fakultetit, më datë 12.06.2025, solli këtë:

VENDIM

për shpalljen e zgjedhjeve të anëtarëve të Kuvendit Studentor të Fakultetit Ekonomik në Universitetin e Tetovës

Neni 1

Shpallen zgjedhje për anëtarë të Kuvendit Studentor të Fakultetit Ekonomik në Universitetin e Tetovës.

Neni 2

Anëtarët e Kuvendit Studentor të Fakultetit zgjidhen në zgjedhje të drejtpërdrejta, të ndershme dhe demokratike me votim të fshehtë.

Kryetari i Kuvendit Studentor të Fakultetit, zgjidhet në mbledhjen e parë konstituive të Kuvendit studentor, nga radhët e anëtarëve të zgjedhur, në përputhje me Statutin e Kuvendit studentor të Fakultetit.

Neni 3

Zgjedhjet për anëtarët e Kuvendit Studentor të Fakultetit do të mbahen me votim të fshehtë më datë 14.07.2025 (e hënë), në sallën nr.215 e mbledhjeve të Fakultetit, me fillim nga ora 08:30 deri në orën 16:30.

Neni 4

Emërohet Komision Zgjedhor për realizimin e zgjedhjeve për anëtarë të Kuvendit Studentor të Fakultetit, në këtë përbërje:

Gazment Deari – profesor në Fakultet – kryetar,

Ali Maksuti – profesor në Fakultet – anëtar,

Ilmie Dauti – studente në semestrin VI, viti akademik 2024/2025, studime të ciklit të tretë në Menaxhment Marketing – me numër indeksi: 220883 – anëtare,

Era Memedi – studente në semestrin IV, viti i dytë në programin studimor Financa dhe Kontabilitet, në vitin akademik 2024/2025 – me numër indeksi: 230536 – anëtare,

Jehona Munishi – studente në semestrin VI, viti i tretë në programin studimor Menaxhment Marketing, në vitin akademik 2024/2025 – me numër indeksi: 220307 – anëtare.

Neni 5

(1) Komisioni Zgjedhor nga neni 4 i këtij Vendimi:

- përcakton rregullat dhe miraton Udhëzuesin për procedurën e zhvillimit të zgjedhjeve;
- përcakton listën e kandidatëve të propozuar, bazuar në verifikimin paraprak nëse kandidatët i plotësojnë kushtet për t'u propozuar si anëtarë të Kuvendit Studentor të

- Fakultetit (nëse janë studentë aktivë, pra të regjistruar në semestrin/vitin në të cilin mbahen zgjedhjet);
- e përcakton pamjen e fletës së votimit/formularëve të procesverbaleve, si dhe dokumentacionin tjetër që del nga rrjedha e procedurës për zhvillimin e zgjedhjeve;
 - e përcakton mënyrën e votimit, numërimin e votave, dhe veprimin ndaj ankesave brenda një afati prej 24 orëve nga momenti i paraqitjes së tyre,
 - kryen edhe detyra të tjera që lidhen me rrjedhën e zhvillimit të zgjedhjeve për zgjedhjen e anëtarëve të Kuvendit Studentor të Fakultetit.

- (2) Udhëzuesi i Komisionit Zgjedhor publikohet në tabelën e shpalljeve/faqen zyrtare të Fakultetit, jo më vonë se 7 ditë para mbajtjes së zgjedhjeve, së bashku me Vendimin për listën e përcaktuar të kandidatëve studentë që i plotësojnë kushtet (lista përfundimtare).

Neni 6

- (1) Kuvendi Studentor i Fakultetit përbëhet nga 5 (pesë) përfaqësues nga secili program studimor të njësive të Universitetit,
- (2) Në rast se nuk plotësohet numri i anëtarëve për secilin program studimor, në përputhje me paragrafin e mëparshëm, për shkak të mungesës së studentëve që i plotësojnë kushtet, vendet e paplotësuara nuk përfshihen në numrin e përgjithshëm të anëtarëve të Kuvendit Studentor të Fakultetit, pra ai do të përbëhet nga aq anëtarë sa ka studentë që i plotësojnë kushtet për t'u zgjedhur dhe që do të jenë të zgjedhur.

Neni 7

Të drejtë të zgjedhin dhe të jenë të zgjedhur si anëtarë të Kuvendit Studentor të Fakultetit kanë të gjithë studentët e Fakultetit, të cilët janë të regjistruar në studime gjatë vitit akademik në të cilin zgjidhet Kuvendi Studentor i Fakultetit.

Kryetar i Kuvendit Studentor i Fakultetit, mund të zgjidhet student i rregullt i cili ka të regjistruar semestrin veror të vitit akademik 2024/25, me notë mesatare së paku 8.00 (tetë).

Neni 8

Anëtarë të zgjedhur të Kuvendit Studentor të Fakultetit konsiderohen ata kandidatë që kanë marrë numrin më të madh të votave nga studentët e Fakultetit që kanë votuar.

Neni 9

Komisioni Zgjedhor obligohet që t'i zhvillojë zgjedhjet në përputhje me Ligjin për arsimin e lartë, Statutin e Universitetit të Tetovës, Statutin e Fakultetit dhe Statutin e Kuvendit Studentor të Fakultetit.

Neni 10

Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e miratimit të tij dhe publikohet në tabelën e shpalljeve/faqen zyrtare të Fakultetit.



Dekani,
Prof. Dr. Brikend Aziri